

20202673513

LIGJ I NDRYSHIMIT TË LIGJIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 dhe 245/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 180/19, 275/19 dhe 31/20), në nenin 11 paragrafi (1) pika 2), fjala "ushtarak" zëvendësohet me fjalët “ushtarak aktiv”.

Neni 2

Në nenin 76 paragrafi 1, pika 3) ndryshohet siç vijon:

“3) çdo 12 muaj të kaluara në mënyrë efektive në ato detyra llogariten si 15 muaj stazh sigurimi, në kryerjen e të gjitha detyrave tjera të cilat i kryen personeli ushtarak dhe civil aktiv i shërbimit të Armatës, në pajtim me Ligjin e Shërbimit në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat nuk janë përfshirë në punët dhe detyrat e pikës 1) dhe 2) të këtij neni.“

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.